

Per orarin e hapjes të bibliotekave në Uddevalla

Lexoni në faqën tonë të internetit bibliotek.uddevalla.se

<p>Biblioteka e qytetit Södergatan 26 tel 69 65 00</p> <p>stadsbiblioteket@uddevalla.se</p>	<p>Biblioteka Dalaberg Dalabergs centrum tel 69 65 43</p> <p>dalabergsbibliotek@uddevalla.se</p>
<p>Ljungskile bibliotek Hälle Lider 2C tel 69 53 47</p> <p>ljungskilebibliotek@uddevalla.se</p>	<p>Autobusi i librave qarkullon sipas listës së rendit që mund të merret në bibliotekat dhe në faqën e internetit të bibliotekës. bibliotek.uddevalla.se tel 69 65 09</p>



Mirësevini në

Bibliotekat e Uddevallas

Rregullat e huazimit



Rregullat e huazimit

Karta e huazimit

Për të huazuar duhet të keni një kartë huazimi. Është pa pages dhe vlen në të gjitha bibliotekat e komunës së Uddevallas.

- Për të marr kartë huazimi duhet të tregoni kartë identiteti me fotografi dhe të firmosni një marrëveshje huazimi.
- Femijët mund të marrin kartë huazimi që kur mbushin 6 vjeç deri në moshin 17 vjeçare. Kujdestari i fëmijes duhet të nënshkruaj marrëveshjen e huazimit.
- Karta e huazimit është dokument personal. Ai/ajo që ka nënshkruar marrëveshjen e huazimi është përgjegjës për gjithçka që huazohet me kartën.
- Në rastë humbje së kartës duhet të raportoni në menyrë që karta të bllokohet.
- Karta e humbur mund të zëvendësohet me një kartë të re kundrejt një tarife dhe tregimit të një mjeti identifikimi të vlefshëm
- Karta e huazimit bllokohet në rast keqpërdorimi dhe nëse borxhi tejkalon 100 krona.
- Ndryshime të adresës ose të emrit duhet të raportohen në bibliotek.

Kodi PIN

Mund të merrni një kod personal (Kodi PIN) për kartën tuaj. Me kodin PIN mund të bëni gjera të mëposhtme në katalogun e bibliotekës në internet:

- Shikoni huazimet tuaja, bëni rihuazim dhe rezervim librash.
- Ndërroni adresën elektronike, etj.
Kodi PIN është personal dhe nuk duhet të jepet borxh.

Huazim – rinovim - rezervim

- Huazime 2 dhe 4 javore mund të rinovohen dy here. Mund të rezervohen.
- Huazime 7 ditore nuk mund të rinovohen dhe as të rezervohen.
- Huazime 7 ditore të filmave nuk mund të rinovohen. Ju ngarkohet një tarifë e re për çdo periudhë të re 7 ditore. Nuk mund të rezervohen.
- Produkte mediatike të rezervuara nuk mund të rinovohen.

Tarifa për vones dhe paralajmërim

- Tarifë për pagesë vonese fillon nga dita e parë e vonesës.
- Tarifa e vonesës fillon kur rinovimi bëhet pas datës së khtimit.
- Asnjë tarifë për produktet mediatike për femijë.

Karta e huazimit bllokohet kur borxhi tejkalon 100 krona.

Nëse produktet mediatike nuk rikthehen në kohën e duhur, biblioteka dergon dy paralajmërme.

Dëmshpërblim

- Huamarrësi është përgjegjës të dëmshpërbleje produktet mediatike të humbur ose të dëmtuar.
- Dëmshpërblimi kryhet sipas një shume të percaktuar. Per produktet mediatike më të shtrejtë, dëmshpërblimi kryhet sipas vlerësimit të bibliotekës. Nëse dëmshpërblimi është kryer kundrejt një pagese, huamarrësi nuk ka të drejtë të kërkojë ripagim të pagesës nëse ai/ajo rikthen produktet.

Huazime dhe të dhëna personale

- Produktet mediatike që huazohen ose rezervohen rregjistrohen në sistemin kompjuterik të bibliotekës.
- Të dhënat personale janë konfidenciale. Një rikthim i mundshëm i kartës do të rezultonte në fshirjen e të dhënave personale.

Komuna e Uddevallës është përgjegjëse për të dhënat personale që gjenden në regjistrin e huazimit. Qëllimi i regjistrimit është që të administrohen huazimet dhe në rast nevojë të përdoret si mjet kërkimi për adresat dhe dërgimin e faturave. Në ligjin mbi të dhënat personale gjenden vendime mbi të drejtën për të patur informacion mbi cilat prej të dhënave personale që përdoren si edhe mbi të drejtën për të korrigjuar të dhënat personale.

Rregullat për përdorimin e kompjuterave dhe internetit

- Përdorimi i kompjuterave është pa pagesë.
- Për prenotimin e kompjuterave të bibliotekës për përdorimin e internetit duhet një kartë huazimi dhe një kod PIN.
- Karta e huazimit dhe kodi janë personal dhe nuk mund të jepen borxh personave të tretë.
- Është i ndaluar dëmtimi dhe manipulimi i kompjuterave dhe programeve të kompjuterave.

Rregullat e bibliotekës për përdorimin e kompjuterave bazohen në statutin e Bashkimit Ndërkombëtarë mbi të drejtat e njeriut:

- Është i ndaluar kërkimi ose dërgimi i materialeve pornografike, raciste ose në ndonjë menyrë tjetër fyese.

Ata që nuk ndjekin rregullat e bibliotekës mund humbasin të drejtën për përdorimin e kompjuterave së bibliotekës.